



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal

i mbajtur më 17 shkurt 2026, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VIII, për nderë të 17 shkurtit - Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: Adelina Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Valdet Kamerolli; Arbrim Kunushefci; Flandra Kadriu; Haki Rudari; Abedin Zeka; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani; (munguan; Kasib Bashota; Florent Hasani; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Avni Islami).

Nga LDK: Enis Shabani; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maçastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi; (munguan; Alisa Jetullahu; Valdet Restelica).

Nga PDK: Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu, (mungoi; Rinesa Goxhufi).

Nga Guxo: mungoi Demokrat Hodolli.

Nga Unioni i Blakçorëve-UB: Gentrif Arifi.

Nga AAK: Baki Feta.

Të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin: z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës; z.Fahri Restelica Nënkrjetari i Komunës; U.D. drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe atë: Arbnorë Uka Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Ahmet Ahmeti-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla Uka-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Azemi-Drejtorja e Kulturës rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuaib Blakçori-Drejtorja e Inspektionit DI; Behram Latifi-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE; (mungoi Ditjona Statovci-Drejtorja e Administratës DA).

Të pranishëm tjerë ishin; Xhemshit Gashi përfaqësues nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së; Idriz Bilalli Bashkësia Islame Podujevë; Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë; Naim Haziri dhe Besnik Nuredini nga Forca e Sigurisë së Kosovës; Kadri Ajeti nga Familja e Heroit Ali Ajeti; Saimir Konushevci dhe Ardi Konushevci nga Familja e Heroit Ilir Konushevci; disa qytetar dhe një numër i zyrtarëve komunale.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë-Himni Kombëtar

• Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i'u dëshiruar të pranishmëve mirëseardhje në këtë mbledhje Solemne për nder të 17 Shkurtit-Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në vazhdim theksoi, të nderuara Familje të Dëshmorëve, Veteranë e Invalidë të Luftës së UÇK-së, i nderuar Kryetar i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, i nderuar Nënkretar i Komunës z.Fahri Restelica, i nderuar Imam i Bashkësisë Islame, Idriz Bilalli, i nderuar Gjeneral i Forcës së Sigurisë së Kosovës Naim Haziri, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë Bashkim Bajrami, përfaqësues të Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-së, të nderuar asambleistë, përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, mysafirë të nderuar, të dashur qytetarë.

Sot, në këtë ditë të shenjtë për Kombin tonë, në 18-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, me nder dhe përgjegjësi të lartë institucionale e shpall të hapur mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës. Kjo është dita kur kujtojmë se liria jonë ka emra, ka gjak dhe ka sakrificë, andaj ju ftoj të ngrihemi në këmbë për të bërë një minutë heshtje në nderim për të gjithë ata që ranë për Kosovën dhe që ne sot të jetojmë të lirë.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe të të rënëve për liri.

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, të nderuar të pranishëm, të dashur qytetarë, më 17 shkurt 2008, në Prishtinë u shqiptua një fjali që ndryshoi fatin e një populli. Ajo nuk ishte vetëm shpallje, ishte frymëmarrje e lirshme pas një shekulli sakrifice, ishte çasti kur dhimbja u kthye në dinjitet dhe sakrifica mori emër shtet. Ajo ditë nuk ishte thjesht një akt juridik, ishte kurorëzimi i një rrugëtimi të gjatë rezistence, ishte momenti kur historia u përkul para sakrificës, kjo datë shënon kulmimi e një procesi të gjatë historik, politik dhe kombëtar, i ndërtuar mbi qëndresë, mbi sakrificë dhe mbi vizion shtet formues.

Pavarësia e Kosovës është rezultat i një përpjekjeje kolektive, i rezistencës paqësore, luftës çlirimtare dhe i mbështetjes së aleatëve tanë ndërkombëtarë, liderët tanë na udhëhoqën drejt pavarësisë me mençuri dhe guxim, në këtë udhëtim historik, Ushtria Çlirimtare e Kosovës përbën kapitullin më të lavdishëm të rrugëtimit për liri.

Të nderuar të pranishëm, kjo ditë na kujton Komandantin Adem Jashari që na mësoi se liria fitohet vetëm me qëndresë dhe atë deri në vetëflijim, Komandantin Zahir Pajaziti që na mësoi se vetëm me organizim dhe guxim ndizet flaka e kryengritjes. Dëshmorët e Llapit dhe të gjithë Kosovës u bënë themeli mbi të cilin qëndron Shteti ynë, këta emra nuk janë vetëm histori, ata janë themele, ata janë betim, ata janë ndërgjegjja e gjallë e shtetit tonë, ata janë arsyeja pse sot flasim të lirë. Lufta jonë nuk kishte asnjë objektiv kundër fëmijëve, grave apo pleqve të komunitetit serb, ndërsa regjimi i Serbisë shkaktoi tmerr të pakufishëm mbi popullatën, vrau dhe masakroj mbi 12000 shqiptar, prej tyre rreth 1500 fëmijë u vranë, disa prej tyre foshnje të sapolindura, ende në djep, mijëra gra, pleq e plaka të pambrojtur u vranë dhe u masakruan, u bënë shumë krime më monstruoze, në lumin Danub u zbuluan trupat e Shqiptarëve kur ujë i qiti mbi sipërfaqe e për të fshehur krimin i kishin hedhur më parë, edhe sot, shumë nëna nuk din ku i kan eshtrat e bijve të tyre, ende kemi varre pa emër, shumë familje ende vazhdojnë të jetojnë në pritje dhe ankth, mbi 400 masakra u kryen në gjithë vendin.

Edhe Llapi dhe Gollaku nuk shpëtuan pa masakra, në Koliq e në Makoc u vranë shumë Shqiptarë pa dallim moshe, por kjo nuk ju mjaftoj kriminelëve serb, ata masakruan edhe shumë familje si ato Bugujevci, Duriqi, Jakupi dhe shumë të tjera.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës u ngrit për të shpëtuar popullin Shqiptar nga shtypja, për dinjitet dhe liri, por sot në këtë ditë feste, ndjejmë edhe mungesën e atyre që udhëhoqën luftën për çlirim, ndjejmë mungesën e Presidentit Hashim Thaçi, të krye Kuvendarëve Jakup Krasniqi e Kadri Veseli, deputetit Rexhep Selimi dhe shokëve të tjerë, në këtë përvjetor, ne kujtojmë me respekt këto figura udhëheqëse të luftës dhe të procesit shtet formues të cilët sot nuk ndodhen fizikisht në mesin tonë, por mbeten pjesë e pandashme e historisë sonë politike dhe institucionale. Historia e Republikës së Kosovës nuk mund të kuptohet pa kontributin e atyre që morën përgjegjësi në momentet më vendimtare të saj.

Sot, më 17 Shkurt, në Kryeqytetin e Republikës sonë në Prishtinë, qytetarët e Kosovës mbledhen dhe protestojnë paqësisht, ata nuk dalin kundër drejtësisë por ata dalin që drejtësia të mos shkëputet nga e vërteta historike, mesazhi i tyre do të jetë i qartë dhe kumbues, Liri për Çlirimtarët, askush nuk mund t'i dënojë në emër të popullit ata që sakrifikuhan për popullin, askush nuk mund ta përmbysë epokën më të lavdishme të historisë sonë moderne, epokën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne besojmë në drejtësi ndërkombëtare, ne besojmë në sundim të ligjit, por po aq fort besojmë se lufta jonë çlirimtare ishte e drejtë, ishte e domosdoshme dhe ishte historikisht e pastër në qëllimin e saj, lirinë. Sot, zëri i qytetarëve në protestë është zë dinjiteti, është zë që thotë se sakrificat nuk fshihet, historia nuk rishkruhet dhe liria nuk vihet në bankën e të akuzuarve.

Sot, nga kjo sallë e Kuvendit Komunal të Podujevës, i bëjë ftesë qytetarëve që sot të jemi së bashku në sheshin Skënderbeu në ora 14:00 në Prishtinë dhe nga aty le të dëgjohet qartë zëri ynë.

Kosova është gjak, ideal dhe përkushtim i një populli që zgjodhi lirinë mbi gjithçka, kjo liri nuk erdhi si dhuratë, ajo erdhi nga pushka e luftëtarit, nga loti i nënës, nga qelia e të burgosurit politik, nga gjaku i Dëshmorëve dhe Martirëve që sot prehen në tokën që e bënë shtet.

Ne sot nuk festojmë vetëm Pavarësinë, ne nderojmë historinë, ne mbrojmë amanetin, ne forcojmë betimin për Republikën.

Llapi dhe Gollaku kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në historinë e qëndresës dhe të lirisë sonë Kombëtare, kjo trevë ka qenë vatër e pashuar e organizimit Kombëtar, kala e pathyeshme e sakrificës dhe zë i fuqishëm i shtetësisë së Kosovës. Kjo trashëgimi na obligon që ne edhe sot të jemi në lartësinë e historisë sonë me përgjegjësi institucionale, me unitet qytetar dhe me vizion zhvillimi.

Kosova është shtet sepse bijtë dhe bijat e saj zgjodhën guximin mbi frikën, sakrificën mbi nënshtrimin dhe lirinë mbi robërinë. Themelet e saj janë ndërtuar mbi gjak, ideal dhe vizion, prandaj ky shtet do të qëndroj sepse është ndërtuar mbi sakrificë të përjetshme dhe mbi vullnet të pathyeshëm për liri, kurse neve na mbetet përgjegjësia për të punuar për një Kosovë më të mirë, më të zhvilluar dhe me perspektivë për të gjithë qytetarët e saj.

Të nderuar të pranishëm, të dashur qytetarë, lavdi Dëshmorëve të Kombit, lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, urime 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, Kryesuesi i Kuvendit vazhdoi me rendin e ditës duke e ftuar Kryetarin e Komunës për një fjalë rasti.

Me këtë rast, Grupi i këshilltarëve të LDK-së lëshuan sallën.

• Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit z.Isak Shabani, i nderuar Nënkyetar i Komunës z.Fahri Restelica, të nderuara Familje të Dëshmorëve, i nderuari Baci Kadri Ajeti vëllai i Dëshmorit të Kombit Ali Ajeti, i nderuari z.Saimir Kunushevc i Dëshmorit të Kombit Ilir Kunushevc, i nderuari z.Xhemshit Gashi vëllai i Dëshmorit të Kombit Mirsad Gashi, shumë i respektuar gjeneral zotëri Naim Haziri, i nderuari Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë z.Bashkim Bajrami, të nderuar drejtorë të Drejtorive Komunale, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, të nderuar përfaqësues të Shoqatave të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuara Familje të Dëshmorëve, të nderuara Media, mysafirë të pranishëm dhe shumë i respektuar Imam z.Idriz Bilalli.

Jemi mbledhur sot në këtë seancë Solemne për të shënuar një nga datat më të rëndësishme historike të Kosovës, 18 vjetorin e Pavarësisë, 17 shkurti i vitit 2008 është dita që shënon një kthesë të madhe në historinë e re të Kosovës, është dita kur u vulos shtetësia e vendit tonë.

Kur shënojmë 17 shkurtin, nuk mund të mos kujtojmë gjithë atë përpjekje shekullore për liri e pavarësi, të atyre burrave e grave, djemve e vajzave që kanë punuar pareshtur gjatë gjithë historisë sonë Kombëtare. Nuk duhet të harrojmë gjithë atë sakrificë të shumë gjeneratave që dhanë gjithçka nga vetja që sot ne të jemi të lirë dhe zot të vetvetes.

Kjo përpjekje shekullore u përmyll me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por pa harruar të përmendim edhe mbështetjen e aleatëve tanë ndërkombëtarë, në veçanti SHBA-në që e ndihmuan luftën tonë çlirimtare.

Në këtë rrugëtim tonin për liri e pavarësi nuk mund të kalojmë pa e përmendur edhe kontributin e Presidentin historik Dr.Ibrahim Rugovën, të veprimtarit të pasqor Adem Demaçi, të Komandantëve Adem Jashari e Zahir Pajaziti dhe shumë të tjerë që në mënyra të ndryshme kontribuan për liri e pavarësi.

Ndërsa ne po e festojmë 18 vjetorin e Pavarësisë, krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po mbahen padrejtësisht në Hagë me akuza të rreme që synojnë ta deformojnë historinë dhe të kaluarën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, uroj dhe shpresoj që shpejt ata të kthehen në vendin tonë duke u bashkuar në festa e gëzime të shtetësisë sonë.

Të nderuar të pranishëm, në këto 18 vjet të shtetësisë, Kosova ka shënuar hapa të rëndësishëm në zhvillimin dhe konsolidimin e shtetit dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, ka shënuar progres në arsim, shëndetësi dhe në të gjitha fushat tjera. Ky përvjetor i 18-të Kosovën e gjen me Ushtri më të fortë, të pajisur me armatim modern. Sot Kosova e ka shtrirë sovranitetin e integritetit territorial në çdo cep. Megjithatë, përpjekjet tona nuk duhet të ndalen asnjëherë për ta zhvilluar dhe forcuar edhe më shumë shtetin tonë, si në aspektin ekonomik, sundim të ligjit, arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, në mënyrë që rinia të ketë perspektivë këtu dhe ku secili qytetar ndihet krenar për shtetin e tij, këtë ua kemi borxh edhe gjeneratave para nesh, ua kemi borxh Heronjve, Dëshmorëve e Martirëve të Kombit të cilët nëpër dekada të ndryshme punuan e sakrifikuan për këtë ditë.

E ardhmja ndërtohet mbi themelet e punës, unitetit dhe shpresës, prandaj le të jetë ky moment reflektimi për ta forcuar besimin dhe për të punuar së bashku për të mirën e vendit.

Urime Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Zoti e bekoftë Kosovën dhe popullin e saj.

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar Kryetarin e Komunës për fjalën e rastit, theksoi, të nderuar, me pjesëmarrjen e Juaj na keni nderuar andaj ju faleminderit për prezencën. Në fund e shpalli të mbyllur këtë mbledhje solemne kushtuar 18 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, duke iu dëshiruar gjitha të mirat ju dhe familjeve tuaja. Mirupafshim në takimet tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 10:30
Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0010137/26
Podujevë, 17 shkurt 2026

Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani